

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHITJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSI NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU</b>
---	---	--

29 nëntor 2012

**SCC – 09 – 0134**

**KBI XX, XX**

Përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Ilir Konushevci 8, Prishtinë

*Paditës*

Kundër

1. **M.S.**, nga XX,  
Përfaqësuar nga avokati XX, XX
2. **H.B.**, nga XX
3. **D.R.**, XX,  
Përfaqësuar nga XX
4. **P.M.**, nga XX,
5. **L.K.**, nga XX,  
Përfaqësuar nga XX

*Të paditur*

Kolegji i parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit i përbërë nga Gjyqtari kryesues Alfred von Keyserlingk, Gjyqtari Shkelzen Sylaj dhe Gjyqtari Çerim Fazliji, pas seancës dëgjimore të mbajtur më 1 nëntor 2012 lëshon këtë

### **Aktvendim**

#### **Padia hidhet poshtë si e papranueshme**

#### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Në padinë e tij të datës 3 mars 2006, të paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë nën C nr 467/06, paditësi kërkon anulimin e kontratës së shitjes në mes të të paditurve në lidhje me disa parcela të tokës dhe konfirmimin e të drejtave të tij të pronësisë mbi pronën.

Me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), që vepron në emër të paditësit, Dhoma e Posaçme më 8 korrik 2009 (RR-09-0001), e ka bartur lëndën nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Në arsyetimin e saj ligjor, Dhoma e Posaçme ka

deklaruar se ka juridiksion primar në lidhje me këtë padi si një padi e ngritur kundër një ndërmarrjeje apo korporate që aktualisht është ose që ka qenë më herët nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), dhe se nuk e ka përcjellë çështjen në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Shkresat e lëndës C.nr.467/06 janë dorëzuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës dhe janë regjistruar në Dhomën e Posaçme si SCC-09-0134 më 20 korrik 2009.

Më 15 tetor 2009, Dhoma e Posaçme refuzoi padinë si të papranueshme. Aktvendimi bazohet në Nenin 28.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 në lidhje me Nenin 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, sipas të cilit Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion për paditë kundër personave fizik.

Në ankesën e paraqitur nga ana e AKP-së më 9 mars 2010, ASC-09-0087, Kolegji i Apelit e kishte anuluar aktvendimin e Dhomës së Posaçme të datës 15 tetor 2009 dhe e kishte urdhëruar Trupin Gjykses që ta rigjykonte padinë.

Në arsyetimin ligjor Kolegji i Apelit ka deklaruar se "Në kundërshtim me konstatimin e Trupit Gjykses, paditë kundër personave fizik nuk përjashtohen *per se* (vetvetiu) nga juridiksioni i DHPGJS-së, siç përcaktohet në Nenin 4.1 të RrEG së UNMIK-ut 2008/4: Siç përvijohet në Aktvendimin e DHPGJS-së për bartje të datës 8 korrik 2009, RR-09-0001, paditë që përfshijnë njohjen e një të drejte, një titulli apo interesi pronësor, që është në posedim apo nën kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrues të AKM-së, i takojnë juridiksionit të Trupit(trupave) Gjykses të DHPGJS-së (shih Nenin 4.1 [d] *leg cit*). Përveç kësaj, Neni 5.2 (e) *leg cit* mbulon paditë kundër "personave të tjerë" OVGJS që DHPGJS-ja "i konsideron të nevojshme për gjykimin e tërësishëm dhe të plotë të rastit nga ajo", duke përfshirë personat fizikë. Në padinë në fjalë, çështja relevante është njohja e të drejtave të pretenduara të pronës në favor të paditësit, NSH-së. Prandaj ajo i takon juridiksionit të DHPGJS-së".

Në mbrojtje të padisë i padituri i parë ka deklaruar se padia duhet të hidhet poshtë. Ai deklaron se shitja e kundërshtuar e pronës është realizuar me miratimin e UNMIK-ut, i cili gjithashtu duhet ta mbajë përgjegjësinë për këtë çështje. Më tej, transaksionet janë kryer në vitin 2005 dhe që atëherë pronat u ishin transferuar individëve të tjerë. Ai nuk është më pronari i pronave, por ato u ishin transferuar individëve të tjerë, P.M. dhe H.B. dhe pastaj D.R. dhe I.K. të cilët nuk janë thirrur në këtë proces gjyqësor.

Në përgjigjen ndaj mbrojtjes paditësi e ka zgjeruar padinë kundër edhe 2 të paditurve të tjerë, P.M. dhe H.B. Paditësi deklaron se ata e kanë marrë pronën në bazë të dokumenteve false.

Më 15 mars 2011 MDD XX ka paraqitur një parashtrësë ku thuhet se ajo e ka interesin e vet në këtë çështje meqë ajo ka pronësinë dhe e posedon pronën që përbën objektin e padisë dhe për këtë arsye kërkon që të informohet për seancën e ardhshme dëgjimore. MDD XX pohon se e ka parashtruar një padi për anulimin e kontratës me Gjykatën Komunale të Prishtinës, e cila e ka shpallur veten si jo kompetente për këtë.

Me urdhrin e Kolegjit të datës 8 gusht 2012 AKP-së i është kërkuar të paraqesë një autorizim që e emëron një avokat i cili është anëtar i shoqatës apo odës së avokatëve për

ta përfaqësuar atë në Dhomën e Posaçme.

Në seancën dëgjimore të datës 1 nëntor 2012 për paditësin është paraqitur S.K., i cili nuk është avokat i regjistruar. Avokati S.M. ka deklaruar se ai vetëm e përfaqëson të Paditurin e parë, M.S. dhe se katër të paditurit e tjerë kanë tërhequr autorizimin e tyre për t'i përfaqësuar ata. I padituri i dytë, H.B., as nuk ishte i pranishëm në seancë dëgjimore, dhe as nuk ishte i përfaqësuar. I padituri i tretë, D.R., është përfaqësuar nga E.R., i cili nuk është avokat i regjistruar. I padituri i katërt, P.M. nuk ishte i përfaqësuar, por ishte personalisht i pranishëm në seancë dëgjimore. I padituri i pestë, I.K. është përfaqësuar nga avokati i regjistruar N.P., të cilin ai e kishte autorizuar një ditë para seancës dëgjimore.

Në seancën dëgjimore të datës 1 nëntor 2012 është paraqitur edhe M.T., duke e përfaqësuar veten si "avokat me shkollë", por duke mos qenë avokat i regjistruar, për 30 ish-punëtorët e KBI XX. Me parashtrësën e datës 23 tetor 2012 ai kërkon t'i lejohet atij të ndërhyjë në proces gjyqësor, duke pretenduar se ish-punëtorët kanë interes ligjor që parcelat e kontestuara t'i transferohen prapë paditësit sepse do ta rriste pjesën e tyre të 20%.

### **Arsyetimi ligjor**

1 .

Padia duhej të hidhej poshtë si e papranueshme.

Paditësi nuk është përfaqësuar si duhet në seancën dëgjimore të datës 1.11.2012.

AKP-ja nuk e ka përfaqësuar paditësin sepse vetë AKP-ja nuk ka qenë e përfaqësuar nga një avokat.

Para Dhomës së Posaçme secila palë, përveç personave fizik, duhet të përfaqësohet nga një avokat (Neni 24 Shtojca e Ligjit 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më tej: Shtojca e LDHP-së).

Kjo vlen edhe për NSH-të e përfaqësuar nga AKP-ja. Formulimit të kësaj dispozite i mungon ndonjë indikacion në lidhje me arsyen pse duhet të vlejë kjo. Neni 73, 74, 85 dhe 86 i Kodit të Procedurës Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006, KPK) që parasheh se kush mund të jetë palë, çfarë veprimesh mund të ndërmarrë pala dhe kush mund ta përfaqësojë një palë lejon që palët dhe përfaqësuesit të cilët nuk janë avokatë të regjistruar të veprojnë në gjykatë, por në lidhje me këto dispozita, Shtojca Neni 24 LDHP është *Lex Posterior* dhe *Lex Specialis*. Ligjvënësi e ka nxjerrë e Shtojcën Neni 24 LDHP kur KPK tashmë ekzistonte dhe ai ka paraparë me Shtojcën Nenin 24 LDHP një procedurë të veçantë në një gjykatë të veçantë, të ndryshme nga gjykatat e tjera të Kosovës. Shtojca Neni 24 LDHP zëvendëson edhe Nenin 29 të Ligjit për AKP-në (04/L-034, Ligji mbi AKP-në), sepse është nxjerrë më vonë dhe nuk e rregullon përfaqësimin në përgjithësi, siç bën Ligji mbi AKP-në por në veçanti para DHPGJS-së. Kjo vlen edhe për Nenin 29.2 të Ligji mbi AKP-në i cili rregullon "pozicionin ligjor" të Agjencisë për të ndjekur të drejtat e ndonjë ndërmarrjeje në gjykatë kompetente në emër të ndërmarrjes në fjalë. Gjithashtu kjo dispozitë mbizotërohet nga dispozita e posaçme, e miratuar më vonë, e nenit 24 të LDHP-së.

Rregullimi ligjor sa i përket asaj që personat fizik nuk kanë nevojë për avokat, por gjithë të tjerët kanë nevojë për avokat nuk shkel Nenin 73 dhe 74 LPK-së. Kjo nuk është e mundur sepse Nenet 73 dhe 74 nuk janë të aplikueshme këtu. Ato zëvendësohen nga Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së.

Kriteri për përfaqësim nga një avokat nuk është shkelje e të drejtës kushtetuese të barazisë para ligjit. Mbetet çështje e hapur nëse AKP-ja si "organ publik" (Neni 1.1 Ligji mbi AKP-në) mund të argumentojë në lidhje me të drejtën themelore të barazisë, që është historikisht dhe në kontekstin e saj kushtetues e drejtë e personave fizik dhe entiteteve private juridike kundër shtetit, dhe jo e drejtë e një organi shtetëror kundër shtetit. I Padituri ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të barabartë, por barazia kushtetuese nuk do të thotë se të gjithë trajtohen njësoj, pavarësisht nëse ato janë aspekte të arsyeshme dhe jo-diskriminuese të diferencimit. Nuk është as e paarsyeshme dhe as diskriminuese që të privilegjojnë personat fizik para gjykatës në raport me entitetet juridike (ose një autoritet shtetëror publik). Shpesh, nëse jo madje edhe rregullisht personat fizik nuk kanë mjete financiare për të përballuar avokatin. Kjo në kuadër të aspekteve kushtetuese është arsye e mjaftueshme për privilegjin e tyre për t'u paraqitur para DHPGJS-së pa një avokat.

Rrjedhimisht mund të thuhet se paditësi, si të gjithë, përveç personave fizik, duhet të përfaqësohet para Dhomës së Posaçme nga një avokat i cili është anëtar i Shoqatës së Avokatëve ose Odës së Avokatëve, përfaqësimi i AKP-së nuk është i vlefshëm pasi që nuk ishte bërë nga një avokat i regjistruar.

Edhe pse paditësi në seancën dëgjimore të datës 1.11.2012 nuk ishte përfaqësuar në mënyrë të rregullt, nuk mund të lëshohet një Aktgjykim në Mungesë sepse të paditurit nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë për një aktgjykim në mungesë kundër paditësit (neni 52 paragrafi 1 dhe 2 të Shtojcës së LDPS-së). Porse nuk ka pasuar asnjë arsye për të shtyrë seancën dëgjimore. Palët nuk mund të shtyjnë procedurën vetëm për shkak se një palë nuk është përfaqësuar në mënyrë të rregullt dhe nëse pala tjetër nuk kërkon një aktgjykim në mungesë.

Gjykata është dashur të lëshojë një aktgjykim sikur të mos kishte fare mungesë. Padia duhet të hidhej poshtë si e papranueshme sepse paditësi nuk ishte përfaqësuar në mënyrë të rregullt.

2.

Ish punëtorët e MDD XX nuk marrin pjesë në këtë procedurë. Ata gjithashtu nuk përfaqësohen në mënyrën të rregullt.

Kërkesa e 9 marsit 2011 është dorëzuar nga M.T., i cili është "avokat i diplomuar", por jo anëtar i shoqatës së avokatëve në Kosovë apo në Serbi (Neni 24.1 i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, e cila ka vlejtur deri më 31.12.2011).

Kërkesa e paraqitur në seancën dëgjimore të datës 1 nëntor 2012 është paraqitur përsëri nga M.T. Shtojca Neni 24 i LDHP-së 04/L-033 e vitit 2012 e bën të domosdoshëm përfaqësimin nga një avokat i regjistruar.

Meqë punëtorët e MDD XX nuk janë përfaqësuar në mënyrë të rregullt gjykata nuk ka

qenë e obliguar të vendosë nëse interesi i tyre në këtë procedurë është thjesht interes ekonomik ose nëse është interes ligjor (Neni 271 Ligji Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Neni 14.4 LDHP-së).

### **Shpenzimet**

Gjykata nuk i cakton shpenzime ankuesit meqë Presidiumi i Gjykatës deri më tani nuk ka nxjerrë planin me shkrim i cili miratohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57 paragrafi 2 Ligji i Dhomës së Posaçme). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për vënien e shpenzimeve.

### **Këshilla ligjore**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet brenda 21 ditëve një apel pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme. Apeli do t'i dërgohet palëve të tjera dhe t'i dorëzohet Trupit Gjyqësor nga ana e Kolegjit të Apelit brenda 21 ditësh. Apeluesi do të dorëzojë pranë Kolegjit të Apelit një dëshmi se i ka dorëzuar apelin palëve tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur apeluesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon apelin si të papranueshëm nëse apeluesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

Të paditurit mund të parashtrojnë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar apeli, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek apeluesi dhe tek pala tjetër.

Apeluesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në apelin e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e apeluesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek apeluesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk,  
Gjyqtari kryesues

[nënshkruar]

Urdhër i brendshëm

Ky aktvendim duhet t'u dërgohet palëve (përkatësisht avokatëve të tyre) dhe M.T.